



POP 5 [Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit]

- 7**
- 2**
- 3**
- 4**
- 5**
-

Kronikë

Dhunoit dhe kërcënoi të shoqen me pistoletë, arrestohet në Palasë 'Visi i Garave'! Arma gjendet e fshehur te tubat e ujit (VIDEO)

Elvis Kosova, një personazh i njohur si "Visi i Garave" është arrestuar këtë të diel në zonën e Palasës. Kosova dyshohet se ka dhunuar e kërcënuar bashkëshorten me një pistoletë pa leje.

■ **Kërcënoi dhe dhunoi bashkëshorten, pistoleta e 'Visit të Garave' e fshehur te tubat e ujit! Policia sekuestron edhe 3 krehra e 2 pako me fishekë (VIDEO)**

Dhunoit dhe kërcënoi të shoqen me pistoletë, arrestohet në Palasë 'Visi
Report TV



Watch on




Këtë të diel në një resort turistik luksoz në jug të vendit është dashur ndërhyrja e forcave të policisë për të arrestuar Elvis Kosovën, personazh i njohur si "Visi i Garave" për shkak të të shkuarës së tij.

Por nuk ka qenë e shkuara që e ka prangosur Kosovën. Në **Palasë** teksa qëndronte për pushime ai dyshohet se ka dhunuar dhe ka kanosur me armë bashkëshorten e tij. Policia njofton se ka marrë njoftimin rreth orës 13:40 për një konflikt familjar, i cili kishte përshkallëzuar dhe për këtë u kërkuan forca shtesë policie, si Forca Kombëtare e Sigurisë, Njësia e Fierit.

Policia thotë se në vilën e kompleksit në zonën e Palasës gjeti një pistoletë të fshehur te tubat e ujit, ndërsa gjatë kontrollit që u bë në banesën e Elvis Kosovës në Tiranë u gjetën edhe dy pako me municion luftarak dhe dy krehra me fishekë.



LEXO EDHE: Zjarri pranë tunelit në Ujin e Ftohtë, flakët rrezikojnë bizneset! Ndërpritet përkohësisht energjia elektrike, situata drejt normalizimit (VIDEO)



Elvis Kosova, 40-vjeçar, njihet si biznesmen në fushën e shitblerjes së automjeteve dhe zotëron edhe një biznes për makina me qira.

Verën e vitit të shkuar, atij iu vendos një **sasi lënde plasëse** në portën hyrëse të **garazhit** të tij në zonën e "Liqenit të Thatë" në Tiranë. Në gusht të vitit 2024 ai u ndalua për vjedhjen e një makine luksoze "Audi R8", me vlerë rreth **200 mijë euro**, që ishte sjellë fillimisht nga Gjermania nga një **turk**, dhe më pas ishte përvetësuar nga Elvis Kosova përmes mashtrimit.

Pasioni i tij janë garat e shpejtësisë dhe shpesh ka marrë pjesë në kompeticione të ndryshme, ku e njohin si "Visi i garave".

Gjatë vitit 2022 biznesmeni është hetuar për organizimin e një gare të paligjshme me makina tek mbikalimi i Patokut. Uniformat blu iu vunë në ndjekje pasi e zbuluan nga videot e hedhura në rrjetet sociale, dhe më tej nga hetimet, rezultoi se Elvis Kosova po e çmontonte në një servis makinën e garës, ndërsa u gjobit nga policia rrugore me 120 mijë lekë të reja. Në këtë sfidë, Elvis Kosova, vinte me fitoren e garës Drag Race, zhvilluar në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 17:31 Kërcënoi dhe dhunoi bashkëshorten, pistoleta e 'Visit të Garave' e fshehur te tubat e ujit! Policia sekuestron edhe 3 krehra e 2 pako me fishekë (VIDEO)

Kërcënoi dhe dhunoi bashkëshorten, pistoleta e
Report TV



Watch on

Konflikti me bashkëshorten që përshkallëzoi deri në **dhunë** e kërcënimin me armë ka vënë në pranga Elvis Kosovën, i njohur si 'Visi i Garave.' Policia e Vlorës bën me dije se kur ka hyrë në banesë ka gjetur një pistoletë, 3 krehra dhe dy pako me fishekë që tanimë janë sekuestruar.

Pistoleta ishte e fshehur në kutinë ku ndodhen tubat e ujit.

Njoftimi i policisë:

Palasë/ Dhunoit dhe kanosi bashkëshorten, arrestohet në flagrancë 40-vjeçari.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë, tre krehra dhe municion luftarak.

Rreth orës 13:40 është marrë njoftim për një konflikt familjar në një vilë të një kompleksi në zonën e Palasës.

Menjëherë kanë shkuar shërbimet e Patrullës së Zonës, të cilat kanë konstatuar një situatë të përshkallëzuar. Për përbalimin dhe neutralizimin e situatës janë angazhuar edhe forca shtesë të Stacionit të Policisë Dhërmi.

Shërbimet e Policisë, gjatë ndërhyrjes në banesë, kanë gjetur një armë zjarri, pistoletë.

Gjithashtu, gjatë kontrollit të banesës në Tiranë, me mbështetjen e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Policia gjeti dhe sekuestroi, në cilësinë e provës materiale, dy pako me municion luftarak dhe dy krehra me fishekë

Nga verifikimet paraprake rezulton se shtetasi E. K. dyshohet se ka dhunuar dhe kanosur bashkëshorten e tij.

Falë ndërhyrjes së menjëhershme dhe në kohë të shërbimeve të Stacionit të Policisë Dhërmi, situata është neutralizuar dhe është parandaluar përshkallëzimi i mëtejshëm i konfliktit, duke shmangur një ngjarje potencialisht të rëndë kriminale.

Shtetasi E. K. është arrestuar në flagrancë dhe është shoqëruar nga Forca Kombëtare e Sigurisë, Njësia Fier, në ambientet e Policisë, ndërsa po kryhen veprimet e mëtejshme procedurale për dokumentimin e plotë të rastit.

P.J/Shqiptarja.com f Share WhatsApp

P.J/Shqiptarja.com

TAG: **armembajtje pa leje** **Dhune** **elvis kosova** **Palase** **Vlore**

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★★★★★★ 1.6 / 5 (10 vlerësime)

★ LAJMET MË TË VLERËSUARA ➤

Komente Komento

- Kryetari Shogates Kurvarve: 23/08/2026 19:23

Ky te vej te bej gara me makina ne burg ,gruaja e ka gjetur direkt pastruesin e oxhakut...
- Makina me qera: 23/08/2026 16:48

Akoma ne xhiro ky visi i leshit?
- Ariu: 23/08/2026 15:59

Rrobqir trim i madh ,kercenon gruan e tij me arme
- Vis pm: 23/08/2026 15:23

Vis pil motla, rri me te forte dhe kujton se eshte e forte... Shofer ordiner

🔒 Ndalohejt repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: Si po menaxhohet situata me zjarret?

23 Gusht, 08:55


Mirë **Keq** **Nuk e di**

Lajme të tjera



Kërcënoi dhe dhunoi bashkëshorten, pistoleta e 'Visit të Garave' e fshehur te tubat e ujit! Policia sekuestron edhe 3 krehra e 2 pako me fishekë (VIDEO)

23 Gusht, 17:31



Arrestohet në Milano reperi italian, Tony Boy del në transmetim 'live' kur policia i hyn në shtëpi! Efektivët gjejnë drogë e armë (VIDEO)

23 Gusht, 17:23



Digjet lokali në Triport, zjarrfikësit shmangin përhapjen e flakëve në Pyllin e Sodës

23 Gusht, 14:56



Pesë ditë pas vrasjes së portugezit te 'Principotes', gjendet thika me të cilën u godit dhe Sokrat Vata! Do dërgohet për ekspertizë (VIDEO)

23 Gusht, 13:01



Arrestohet 'si nëpër filma', 32-vjeçari rrethohet nga policia në Tiranë dhe nxirret nga makina në 5 sekonda! I gjetet pistoletë pa leje dhe 15 800 euro (EMRI+VIDEO)

23 Gusht, 12:06



Një perlë mes maleve të Labërisë, Ujëvara e Rasalit në Vlorë po tërheq gjithnjë e më shumë vizitorë (VIDEO)

23 Gusht, 11:52



'Ushtarët izraelitë dogjën pallatin/ Si u përdor zjarri në Vlorë për propagandë anti-izraelite, historia nisi nga një profil satirik

23 Gusht, 09:29



Fundi i sezonit veror/ 41 mijë qytetarë nga Kosova hyjnë në Shqipëri për fundjavë, 8 mijë pasagjerë largohen nga Porti i Vlorës drejt Italisë

23 Gusht, 08:13




'Më ço në spital, nxito', zbardhet dëshmia e DJ të klubit për Sokrat Vatën bes vrasjes së portugezit te 'Principotes'

22 Gusht, 17:40



'Ksamili mes 50 plazheve më të mira në botë, lë pas Maldivet'- Big 7 Travel: Uj i kaltër i detit dhe rëra e bardhë po magjepsin turistët

22 Gusht, 16:30



'I gjithë sherri jashtë lokalit minutë pas minute', Report Tv siguron pjesë nga dosja e vrasjes së portugezit te 'Principotes' në Ksamili! I riu u fut në det për të shpëtuar

22 Gusht, 12:06



Delegacioni i Global Sumud Flotilla në Vlorë, Ministria e Turizmit u 'zë pritë': Erdhën për të shpëtuar Sazanin, por nuk shkuan në ishull! Rama: Revolucionarët e rrenave i ikin të vërtetës si djalli temianit (VIDEO)

22 Gusht, 15:44


Lajmi i fundit



Kriza në Kosovë/ PDK nuk heq dorë, i dërgon sërish letër Deharit: Të hënën në 11:00 deputetët do të jenë në sallë

23 Gusht, 22:54





Kriza në Kosovë/ PDK nuk heq dorë, i dërgon sërish letër Deharit: Të hënën në 11:00 deputetët do të jenë në sallë

23 Gusht, 22:54